



VENDIM

Nr. 59, Datë 29.04.2016

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PER MIRATIMIN E “KUSHTEVE TE
PERGJITHSHME TE KONTRATES SE SHERBIMIT UNIVERSAL TE
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTET
FUNDORË”**

Ne mbeshtetje te nenit nenit 16, 20 gërmat “a” dhe “h”; nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 25 të “Rregullave te Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 21, date 18.03.2009, të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e draft – Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit;

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kushteve të përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë.
2. Drejtoria Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palet e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI**